



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5148 /2023
Data: 22.06. 2023

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e pestë –V- për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 29.05.2023 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Pasi që Kryesuesi i Komitetit ka paralajmëruar se do të vonohet pakë sipas rregullores mbledhjen mund ta udhëheqë anëtari më i vjetër i Komitetit për Komuniteteve dhe sipas datëlindjeve është z. Zaim Bela.

Zaim Bela thekson:- pasi që kryesuesi i komitetit për arsye shëndetësore vonohet pak dhe besoj që ndërkohë do të na bashkëngjitet. Për këtë mbledhje janë paraparë këto pika të rendit të punës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Kryesuesit e Komiteteve Konsultative.
3. Takim me përfaqësuesit e Këshillave të Fshatrave.
4. Takim me Përfaqësuesin e Bizneseve në Han të Elezit.
5. Eventuale.

A keni ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Zaim Bela thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Kryesuesit e Komiteteve Konsultative.

Zaim Bela thekson:- janë katër Komitete Konsultative ftesë për pjesëmarrje të gjithë kryesuesit kanë pasur por nuk janë prezent. A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e tretë të rendit të punës.

3. Takim me përfaqësuesit e Këshillave të Fshatrave.

Zaim Bela thekson:- sipas rregullores janë të formuara katër këshilla të fshatrave por edhe këto nuk janë prezent. A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e katër të rendit të punës.

4. Takim me Përfaqësuesin e Bizneseve në Han të Elezit.

Zaim Bela thekson:- edhe nga përfaqësuesit e bizneseve nuk kemi prezent, a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës , nëse nuk ka kalojmë në pikën e pestë të rendit të punës.

5.Eventuale

Zaim Bela thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson:- komuna e ka shpërndarë njoftimin për dhurimin e gjakut që do të bëhet dhe është mirë që ta sensibilizojmë këtë çështje te qytetarët.

Zaim Bela thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në 14:25.

Procesmbajtësja
Sara Berisha

